

Nr. Extra prot.

Tiranë më 23/12/2021

OBJEKTI: *Njoftim mbi vendimarrje të Partisë Demokratike të Shqipërisë*

DREJTUAR: z. Lulzim Basha

Deputet i Partisë Demokratike të Shqipërisë

PËR DIJENI: Trupit Diplomatik të akredituar në Shqipëri

Zoti deputet!

Partia Demokratike e Shqipërisë në muajt e fundit është dashur të përballet me një sërë sfidash dhe problematikash serioze, të cilat pavarësisht rezultatit dramatik elektoral në zgjedhjet e përgjithshme, nuk e kanë tronditur moralin e demokratëve dhe besimin e tyre se familja jonë politike do të kthehet shumë shpejt një alternativë serioze qeverisëse, e cila do të meritojë besimin dhe mbështetjen e shumicës së shqiptarëve.

Fatkeqësish, në të njëjtën kohë dhe jashtë vullnetit të tyre, demokratëve u është dashur të përballen edhe me krizën më të rëndë të identitetit dhe demokracisë së brendëshme të partisë që nga koha e themelimit të saj, veçanërisht për shkak të mosfunkcionimit të forumeve të saj vendimarrëse, si dhe përvetësimit të kompetencave të organeve qendrore të partisë nga ish kryetari i saj.

Në këto kushte, të ndodhur përballë indiferencës dhe pamundësisë për të ndryshuar situatën e demokracisë së brendshme nëpërmjet rikthimit në krye të detyrës së organeve qendrore të partisë, një grup deputetësh, antarësh Kryesie, antarësh të Këshillit Kombëtar, kryetarë degësh, grupseksionesh, seksionesh, delegatë të organit më të lartë drejtues të Partisë, Kuvendit Kombëtar, në përputhje me parashikimet statutore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, morën përgjegjësinë historike të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, më datë 11.12.2021.

Qëllimi i vetëm i kësaj thirrje ishte shpëtimi i Partisë Demokratike nëpërmjet rikthimit në legjitimitet moral, politik dhe statutor të funksionimit të saj, për t'a rikthyer atë në misionin e saj fillestare si shpresë për demokratët dhe njerzit e lirë të këtij vendi në mbrojtjen e vlerave perëndimore dhe Euro-Atlantike.

Me vendimin nr. 6, dt. 11.12.2021, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, organi më i lartë i saj sipas Statutit, ka vendosur shkarkimin tuaj nga detyra “për thyerje të

rënda të Statutit të Partisë Demokratike, përvetësim të kompetencave të organeve qëndrore të Partisë Demokratike dhe dëmtim të rëndë të interesave politike dhe elektorale të saj.”

Pavarësisht se sipas nenit 43, shkronja ç), e Statutit, kjo vendimarrje mund të ishte vetëm e Kuvendit Kombëtar të PDSH, ky i fundit, në respekt të mijëra demokratëve të cilët në datën 13 qershor 2021 kishin votuar për kryetarin e PDSH sipas parimit “një anëtar; një votë”, vendosi t’ë ratifikonte vendimarrjen për shkarkim nëpërmjet referendumit në të gjithë anëtarësinë, të mbajtur po sipas të njëjtë parim.

Referendumi konfirmues është mbajtur në datën 18.12.2021, sipas disponimeve të Kuvendit Kombëtar në vendimin e sipërcituar, dhe rezultati i tij përfundimtar, sipas procesverbalit bashkëlidhur, sanksionon se 43385 demokratë nga 43879 demokratë votues, kanë vendsur në favor të vendimit të Kuvendit Kombëtar dhe për shkarkimin tuaj nga detyra e kryetarit të PDSH.

Komisioni i Përkozhshëm i Rithemelimit të PD, i krijuar si vullnet i Kuvendit Kombëtar, si organi më i lartë ekzekutiv i partisë deri në krijimin e organeve të reja sipas Statutit, me anë të këtij komunikimi zyrtar ju fton të njiheni me vullnetin e anëtarësisë së Partisë Demokratike dhe atë të organeve më të larta vendimarrëse të kësaj partie.

Përsa më sipër, kërkohet nga ana juaj që të merrni të gjitha masat përkatëse për t’ë jetësuar vullnetin e qartë të demokratëve, të shprehur nëpërmjet vendimit të Kuvendit dhe referendumit si mekanizëm i demokracisë së drejtpërdrejtë, duke liruar ambientet e punës së Kryetarit të Partisë, si dhe duke kryer menjëherë dorëzimet përkatëse te Komisioni i Përkozhshëm i Rithemelimit të PDSH, deri më datë **05/01/2022**

Refuzimi i vendimit të Kuvendit Kombëtar, si organi më i lartë statutor i Partisë Demokratike të Shqipërisë, si dhe refuzimi i vullnetit të 43385 anëtarëve të PDSH të cilët ratifikuan vendimin e shkarkimit tuaj, do të detyrojë anëtarësinë të shndërrohet në përbaruesin politik të vendimit dhe vullnetit të saj.

Bashkëlidhur do të gjeni Statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, vendimin nr. 6 dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të PDSH, si dhe vendimin e miratimit të rezultatit përfundimtar të Referendumit të datës 18.12.2021.

Mbetemi të bindur se do t’ë kuptioni domosdoshmërinë jo vetëm statutore, por edhe politike e morale, të zbatimit të vullnetit të qartë të demokratëve.

KOMISIONI I PËRKOZHSHËM I RITHEMELIMIT

*Keltis kruje Deton
BELINDA KELIĆI Belind Kelić
Juan Basi Juan
Gugelj Musollari Gugelj
BESAR MISHAMI Besar
Edmond Spahiu Edmond
Jelendi Hima Jelendi
ERVIN MINAROVIĆ Ervin
Klavdi Boalli Klavdi*

*Elvira Lora Elvira Lora
Genc Janović Genc Janović
Qemal Maruni Qemal Maruni
Elmar Noka Elmar Noka
Selim Meço Selim Meço
Rimza Hajdar Hotaj Rimza Hajdar Hotaj
Alojz Butina Alojz Butina
Tritan Shala Tritan Shala
Elvirim Gjata Elvirim Gjata
Abbas Vashki Abbas Vashki*